



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 29/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat [REDACTED] si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, dhe përmbarduesit privat, [REDACTED] dhe pas seancës këshillimore, me datën 02.11.2021, mori si në vijim:

V E N D I M

REFUZOHEN raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-29/2021, datë 28.09.2021, si dhe ankesa pala ankuese [REDACTED] përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar [REDACTED] dt 23.09.2021, si të pabazuara.

A r s y e t i m

Me datën 23.09.2021, pala ankuese [REDACTED] përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar Av. [REDACTED] ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë- Departamentin për Profesione të Lira, Divizionin për Noterinë dhe Përmbardimin Privat ndaj përmbarduesit privat [REDACTED] për shkelje disiplinore. Pala ankuese thekson që përmbarduesi privat ka vepruar në kundërshtim me nenin 367 par 1.2 të LPP-së pasi gjatë ndërmarrjes së veprimeve në kuadër të autorizimeve të tij, ai nuk i është përmbajtur ligjit. Shton se me dt 13.02.2017 është nxjerrë urdhri përmbardimor P. nr 276/17 ndaj palës debitore [REDACTED] dhe z [REDACTED] për përmbushjen e borxhit në vlerë prej 2,570.45 Euro me kamatë ligjore. Sipas palës ankuese, përmbarduesi privat nuk ka ndërmarr asnjë veprim për përmbushjen e obligimit me përjashtim kërkesës drejtuar bankave për informata

lidhur me llogaritë aktive të debitorit. Shton se ai ka njoftuar përmbaruesit privat se pala debitore [redacted] është në marrëdhënie pune në Policinë e Kosovës dhe përmbaruesi privat ka bërë bllokimin e llogarive bankare të tij dhe në momentin e bllokimit të llogarive bankare debitori ka kërkuar arritjen e një marrëveshje në mënyrë që borxhi të paguhet me këste. Pala ankuese thekson se me dt 01.07.2019, palët- kreditori dhe debitori, në zyrën e përmbaruesit privat kanë nënshkruar marrëveshje për pagimin e borxhit, në total në shumën prej 3,002.69 Euro, i cili do të paguhej në 12 këste. Megjithatë, sipas palës ankuese marrëveshjes nuk i është përmbajtur pala debitore dhe përkundër që ai ka njoftuar përmbaruesit privat për dështimin e marrëveshjes mes tij dhe palës debitore, përmbaruesit privat nuk i ka kthyer përgjigje. Pala ankuese thekson që ka pësuar dëme financiare.

Me datën 28.09.2021, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit private [redacted], si organ përmbarues, i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted] lidhur me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore në lëndën P. nr 276/2017.

Përmbaruesi privat [redacted] në përgjigjen e tij me shkrim thekson se urdhri për përmbarim P. nr 276/17 është lëshuar me dt 13.02.2017. Me dt 14.03.2017 është bërë bllokimi i llogarive bankare të palës debitore. Sipas përmbaruesit privat, pas bllokimit të llogarive, me dt 01.07.2019, palët kanë arritur marrëveshje për përmbushje të detyrimit dhe rrjedhimisht llogaritë janë liruar. Pasi që marrëveshja ka dështuar, përmbaruesi privat thekson se përsëri ka bllokuar llogaritë bankare të palëve debitore. Po ashtu, janë ndërmarr veprime për automjete dhe pasuri të paluajtshme. Rrjedhimisht, përmbaruesi privat thekson se si organ përmbarues ka ndërmarr gjitha veprimet ligjore.

Me datën 02.11.2021, Komisioni ka mbajtura seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, dhe përmbaruesit privat [redacted]

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat duke theksuar se mbetet pranë propozimit. Përmbaruesi privat gjithashtu kanë paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e ngritura.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbaruesi privat [redacted] nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson se në rastin konkret ankesa, në thelb, konsiston në pretendimin se përmbaruesi privat [redacted] nuk ka ndërmarr veprimet ligjore për përmbarim. Pas shqyrtimit të shkesave të lëndës, Komisioni megjithatë gjen se pretendimi i palës ankuese se përmbaruesi privat nuk ka ndërmarr veprime ligjore në drejtim të përmbarimit të rastin në fjalë është i paqëndrueshëm. Nga shkesat e lëndës është evidente që urdhri përmbarimor është

lëshuar me dt 13.03.2017 mbi bazën e propozimit të palës debitore. Me dt 14.03.2017, përmbaruesi privat [REDACTED] ka realizuar bllokimin e llogarive bankare të palës debitore. Pas bllokimit të llogarive, me dt 01.07.2019, vet palët në procedurën përmbarimore kishin arritur marrëveshje për përmbushje të detyrimit. Si rezultat, përmbaruesi privat [REDACTED] i ka liruar llogaritë bankare të palës debitore. Pasi që përmbaruesi privat ishte njoftuar që marrëveshja mes palëve për përmbushje vullnetare kishte dështuar, përmbaruesi privat sërish ka ndërmarr veprime ligjore duke bllokuar llogaritë bankare të palëve debitore, siç evidentohet nga urdhëresa për bllokimin e llogarive dt 18.11.2019. Po ashtu, siç thekson edhe vet përmbaruesi privat ai kishte ndërmarr veprime për identifikimin e automjeteve dhe pasuri të paluajtshme të palës debitore. Vetëm fakti se përmbarimi nuk ka mundur të realizohet për shkak se pala debitore nuk ka mjete në llogaritë bankare dhe as pronë në emër të tij që do të mundësonin realizimin e suksesshëm të përmbarimit, nuk mund t'i atribuohen përmbaruesit privat si lëshime. Përmbaruesi privat ka ndërmarr gjitha veprimet ligjore brenda afateve pa vonesa të paarsyeshme. Rrjedhimisht, Komisioni vjen në përfundim se përmbaruesi privat në lëndën konkrete, ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet e tij.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 29/2021, datë 02.11.2021**

**Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI**



KËSHILLË JURIDIKE:


Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

Faint, illegible text at the top of the page, possibly bleed-through from the reverse side.

Faint, illegible text line.

Faint, illegible text line.

Faint, illegible text line.



Faint, illegible text line.

Faint, illegible text line.